Институт за јавно здравје
Institute of public health
Instituti i shëndetit publik

# Neoplazmat malinje problem i shendetit publik ne jetesen bashkekohore

Институт за јавно здравје
Institute of public health
Instituti i shëndetit publik

# Faktoret e rezikut

Kanceri lind nga një qelizë e vetme. Transformimi i qelizave normale ne qeliza tumorale eshte nje proces multistage zakonisht progres nga lezione pre - kanceroze ne tumore malinje. Këto ndryshime janë rezultat i bashkëveprimit në mes të faktorëve gjenetik dhe të agjentëve të jashtëm e duke përfshirë faktoret :

Fizik: UV dhe rrezatimi jonizues

Kimik: asbesti , përbërësit e tymit të duhanit , aflatoxinat (ndotësit e ushqimit), arseniku(papastërtite e ujit të pijshëm ) dhe

Biologjik: infeksionet nga viruset , bakteret e caktuara ose parazitët

Mosha, predispozita gjenetike

# Faktoret e rezikut

Plakja është një tjetër faktor themelor për zhvillimin e kancerit .

Incidenca e kancerit të rritet paralelisht me moshën. Pirja e duhanit, konsumi i alkoolit, dietat jo te shendetshme dhe pasiviteti fizik janë faktorët kryesorë të rrezikut për rritjen e sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë në mesin e popullatës në botë

Infeksion kronik i virusit të hepatitit B ( HBV ) , virusi i hepatitit C ( HCV ) dhe disa lloje virusi te njeriu ( HPV ) janë faktorët kryesore te rrezikut për kancerin në vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme. Neoplazma malinje e qafës së mitrës të shkaktuar nga HPV , eshte shkaku kryesor i vdekjes nga kanceri në mesin e grave në vendet me të ardhura të ulëta.

Институт за јавно здравје
Institute of public health
Instituti i shëndetit publik

# Gjendja me neoplazmat malinje ne bote

## Vlerësimet e GLOBOCAN 2012:

Kanceri është shkaku kryesor i vdekjeve në mbarë botën dhe shkakatar për 8,2 milion vdekje (rreth 14% të të gjitha vdekjeve) në vitin 2012
Në vitin 2012 ka rreth 14.100.000 raste të reja malinje dhe 32,6 milion njerëz me kancer (më shumë se 5 vjet te diagnostifikuar me kancer)
Tumoret malinje të mushkërive, stomakut, mëlçisë, zorrës së trashë dhe të gjirit janë shkaqet më të shpeshta të vdekjes çdo vit
Rreth 30% e vdekjeve nga neoplazmat malinje ndodhin për shkak të pesë faktorëve kryesorë të rrezikut: sjelljeve jo të shëndetshme dhe dietave jo te shendetshme, mbipeshes ,konsumit te manget te frutave dhe perimeve në dietë, mungesa e aktivitetit fizik, pirja e duhanit, konsumi i alkoolit etj .
Duhani është faktori më i rëndësishëm i rrezikut për kancerin dhe shkaku i 22% të të gjitha vdekjeve nga neoplazmat malinje dhe në 71% të të gjitha vdekjeve nga Neoplazma malinje e mushkërive.

Институт за јавно здравје
Institute of public health
Instituti i shëndetit publik

# Gjendja me neoplazmat malinje ne bote

- Përafërsisht rreth 66 % të totalit të vdekjeve nga neoplazmat malinje në vitin 2012 jane të regjistruara në vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme
- Sipas vlerësimeve nga OBSH numri i vdekjeve nga kanceri në botë do të rritet në 13.100.000 ne vitin 2030
- Ne vend te parë në botë në vitin 2012 është: kanceri i mushkërve me incidence 13.0 % OOO , neoplazma malinje e mëlçisë me shkalle te incidencës 11.9 % OOO , neoplazma malinje e stomakut me shkalle te incidencës 9.7 % OOO etj.
- Numri i përgjithshëm i vdekjeve në rang të parëvjen nga kanceri i mushkërive ku Shkalla e vdekshmërisë sillet 19.4 % , e ndjekur nga kanceri i mëlçisë ( 9.1 % OOO ) , stomakut ( 8.8 ) etj .

Институт за јавно здравје
Institute of public health
Instituti i shëndetit publik

# Gjendja me neoplazmat malinje ne bote

## Shkalla e standardizuar e mortalitetit nga neoplazmat malinje ne botë, në vitin 2012



Институт за јавно здравје
Institute of public health
Instituti i shëndetit publik

# Gjendja me neoplazmat malinje ne bote

## Incidenca nga neoplazmat malinje ne vitin 2012, shkalla ne 100 000 banore ne nivel global



Институт за јавно здравје
Institute of public health
Instituti i shëndetit publik

# Gjendja me neoplazmat malinje ne Maqedoni, morbiditeti

- Në Strukturën e grupeve më të shpeshta të sëmundjeve të trajtuara në veprimtarinë spitalore-stacionare në Maqedoni, neoplazmat malinje të zënë vendin e tretë me 11.4% të totalit të trajtuar në vitin 2015, pas sëmundjeve të sistemit respirator (16.8%) dhe sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut (13.1%).
- Në periudhën dhjetë-vjeçare, 2006-2015, në lëminë spitalore stacionare mesatarisht në vjet trajtohen 28.936 pacientë që vuajnë nga neoplazmat malinje, me një mesatare vjetore rreth 12.1% të neoplazmave malinje të trajtuara në total.
- Në periudhën 2013-2015, në veprimtarinë spitalore -stacionare mesatarisht në vjet trajtohen 29.289 pacientë që dioagnostifikohen me neoplazma malinje, me pjesëmarrje mesatare vjetore prej 11.5% të neoplazmave malinje të trajtuara në total.

Институт за јавно здравје
Institute of public health
Instituti i shëndetit publik

# Morbiditeti Gjendja me neoplazmat malinje ne Maqedoni, morbiditeti

## Struktura e patologjive me te shpeshta ne vitin 2015, ne spitale e shprehur ne perqindje



Институт за јавно здравје
Institute of public health
Instituti i shëndetit publik

# Gjendja me neoplazmat malinje ne Maqedoni, morbiditeti

## Numri i të prekurve nga neoplazmat malinje ne republikën e Maqedonisë te mjekuar në spitale në periudhën 2006-2015



Институт за јавно здравје
Institute of public health
Instituti i shëndetit publik

# Gjendja me neoplazmat malinje ne Maqedoni, morbiditeti

***Shkalla e përqindjes së neoplazmave malinje te pacientët e trajtuar në spitale në Maqedoni e llogaritur ne 10 000 banorë, në periudhën 2006-2015.***



Институт за јавно здравје
Institute of public health
Instituti i shëndetit publik

# Gjendja me neoplazmat malinje ne Maqedoni, morbiditeti

## Morbiditeti nga neoplazmat malinje, te trajtuara ne spitale ne vitin 2015 ne Maqedoni, shkalla na 10 000 banore




**Shpërndarja territoriale e normave të morbiditetit në 10 000 banorë të pacientëve të trajtuar në spitale sipas rajoneve statistikore në Maqedoni në vitin 2015.**

Институт за јавно здравје
Institute of public health
Instituti i shëndetit publik

# Vdekshmëria nga neoplazmat malinje në Republikën e Maqedonisë

- Tumoret malinje janë shkaku i dytë i vdekjes në mesin e popullatës në vend me përfaqësim 18.3% në strukturën e vdekjeve të përgjithshme menjëherë pas sëmundjeve të sistemit të qarkullimit të gjakut me 58.4% në 2015.
- Në Maqedoni mesatarisht 3741 njerëz në vit vdesin nga neoplazmat malinje si shkak kryesor i vdekjeve. Vlera mesatare vjetore e neoplazmave malinje në totalin e te gjitha vdekjeve në periudhën e analizuar ka qene 18.3%.
- Në vitin 2015 në Republikën e Maqedonisë nga neoplazmat malinje kanë vdekur 3741 persona ose me shkallë vdekshmërie për persona 180,7 në 100,000 banorë.
- Numri është rritur 16.5% në krahasim me vitin 2005 kur janë regjistruar 3212 vdekje me normë prej 157,7 në 100.000 banorë. Në periudhën e analizuar 2005-2015, trendi i vdekshmërisë tregon një tendencë në rritje.

Институт за јавно здравје
Institute of public health
Instituti i shëndetit publik

# Vdekshmëria nga neoplazmat malinje në Republikën e Maqedonisë

## Shkalla e vdekshmerise ne 100 000 banore, nga neoplazmat malinje në Republikën e Maqedonisë, periudha 2005-2015



Институт за јавно здравје
Institute of public health
Instituti i shëndetit publik

# Vdekshmëria nga neoplazmat malinje në Republikën e Maqedonisë sipas gjinise

**Shkalla e vdekshmerise nga neoplazmat malinje sipas gjinise, e llogaritur ne 100000 banore ne Republiken e Maqedonise , periudha 2005-2015**




**Shpërndarja sipas gjinisë e numrit të vdekjeve nga neoplazmat malinje tregon tendencë pozitive të zhvillimit në të dy gjinitë. Normat e vdekshmërisë janë më të larta tek meshkujt.**

Институт за јавно здравје
Institute of public health
Instituti i shëndetit publik

# Vdekshmëria nga neoplazmat malinje në Republikën e Maqedonisë




Vdekshmëria nga neoplazmat malinje rritet paralelisht me moshën. Frekuenca më e madhe e regjistruar e vdekjeve nga neoplazmat malinje si shkaku kryesor i vdekjes verehet te moshat mbi 45 vjet. Më shumë se gjysma e vdekjeve nga neoplazmat malinje janë të moshës mbi 65 vjeçe, me përfaqësim 57.7 % të totalit të vdekjeve nga neoplazmat malinje në vitin 2015.

# Vdekshmëria nga neoplazmat malinje në Republikën e Maqedonisë

## Vdekshmëria nga neoplazmat malinje shkalla ne 100 000 banore në Republikën e Maqedonisë, sipas lokalizimit te neoplazmave malinje, periudha 2013-2015




Sipas analizës nga shkaqet më të zakonshme të vdekjeve nga neoplazmat malinje sipas diagnozave më të shpeshta janë rastet me kancer të mushkërive me shkallën më të lartë të vdekshmërisë me 40,6 % ooo në vitin 2015

Институт за јавно здравје
Institute of public health
Instituti i shëndetit publik

# Vdekshmëria nga neoplazmat malinje në Republikën e Maqedonisë

## Vdekshmëria nga neoplazmat malinje te mushkerive te meshkujt, shkalla ne 100 000 banore në Republikën e Maqedonisë, periudha 2013-2015




Për sa i përket strukturës sipas shkaqeve më të zakonshme të vdekjeve sipas diagnozave individuale, te meshkujt në vend të parë radhitet neoplazma malinje e mushkërive me normë më të lartë të vdekshmërisë prej 64.7 vdekje për 100,000 banorët të gjinisë mashkullore në vitin 2015.

# Vdekshmëria nga neoplazmat malinje në Republikën e Maqedonisë, 2015



# Vdekshmëria nga neoplazmat malinje në Republikën e Maqedonisë

## Vdekshmëria nga neoplazma malinje e gjirit te femrat , shkalla ne 100 000 banore në Republikën e Maqedonisë, periudha 2013-2015




Te femrat si shkaku më i shpeshte i vdekjeve ne rang te parë radhitet kanceri i gjirit me normën më të lartë të vdekshmërisë prej 27.2% ooo, pra në vitin 2015 kanceri i gjirit ishte shkaku kryesor i vdekjes.

# Vdekshmëria nga neoplazmat malinje në Republikën e Maqedonisë

## Tumoret malinje me te shpeshta te femrat, sipas shkaqeve te vdekjeve ne vitin 2015



Институт за јавно здравје
Institute of public health
Instituti i shëndetit publik

# Vdekshmëria nga neoplazmat malinje në Republikën e Maqedonisë sipas regjioneve statistikore



Институт за јавно здравје
Institute of public health
Instituti i shëndetit publik

# Rekomandime

Aplikimi dhe zbatimi i veprimeve parandaluese:

Skriningu dhe zbulimi i hershëm, ndryshimi i stilit jetesor

të popullates i lidhur me rrezikun ndaj sëmundjeve malinje (dieta te shendetshme , ndalimi ose reduktimi i pirjes se duhanit, alkoolit etj.) aktiviteti fizik, kontaktet seksuale te mbrojtura).

Reduktimi i faktorëve të tjerë të rrezikut,

Përmirësimi dhënave per evidentimin e semundjeve malinje

Sistemi shëndetësor i integruar i regjistrimit,

Kryerja e aktiviteteve promovuese

Mbështetja nga organizatat ndërkombëtare dhe vendore për kërkime shkencore në këtë fushë dhe zbatimi i programeve të parandalimit